



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2024:244621
Datë: 21.10.2024
Numri i dokumentit: 06328994

PPP.nr.189/24

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC, Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil, gjyqtari i vetëm Avni Berisha, me bashkëpunëtoreshen profesionale Shpresa Haxhijaha Rahmani, në lëndën përmbarese të kreditorit B.H nga Rahoveci, të cilin e përfaqëson i autorizuari Av. D.M nga Prizreni, kundër debitorës Komuna e Rahovecit, Drejtoria Komunale e Arsimit, duke vendosur sipas propozimit të debitorit të ushtruar kundër urdhërit të përmbaresit privat B.B P.nr.6585/24, të datës 18.07.2024, më 21.10.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. **APROVOHET** pjesërisht si i bazuar propësimi i debitorit Komuna e Rahovecit, Drejtoria Komunale e Arsimit, ashtu që SHFUQIZOHET urdhëri të përmbaresit privat B.B nga Peja, P.nr.6585/24, të datës 18.07.2024, sa i përket kërkesës së përfaqësuesit të autorizuar të kreditorëve që në emër të shpenzimeve për përpilimin e propozimit për përmbarim të paguaj shumën prej 28,08 euro në emër të TVSH-18%.
- II. **MBETET NË FUQI** urdhri i përmbaresit privat B.B, nga Peja P.nr.6585/24, të datës 18.07.2024, me të cilin është caktuar përmbarimi e borxhit për shkak të detyrimit në të holla në emër të kompensimit të diferencës së pagës për inflacionit, kreditorit B.H nga Rahoveci, ti paguaj shumën prej 840.00 euro, me kamatë prej 8 %, nga dita e paraqitjes së padisë me datë 01.06.2022, si dhe në emër të shpenzimeve të procedurës përmbarimore për përpilimin e propozimit të paguaj shumën prej 156.00 euro.

A r s y e t i m

Në bazë të propozimit të kreditorit B.H nga Rahoveci, përmbaresi privat B.B nga Peja, ka lejuar përmbarimin sipas urdhrit P.nr.6585/24, të datës 18.07.2024, në bazë të dokumentit përmbarimor, Aktgjykimit C.nr.361/2022, i datës 10.06.2024, i plotfuqishëm me datë 02.07.2024, i ekzekutueshëm nga data 10.07.2024, kundër debitorit Komuna e Rahovecit, Drejtoria Komunale e Arsimit, për shkak të detyrimit në të holla në emër të kompensimit të diferencës së pagës për inflacionit, në shumën e përgjithshme prej 840.00 euro.

Kundër urdhrimit me të cilin është caktuar përbarimi, debitori Komuna e Rahovecit, ka paraqitur prapësim me të cilin ka kundërshtuar urdhrin për caktimin e përbarimit, pasi që sipas tij, propozimi përbarim kërkesë e cila është e pa lejuar sepse propozimi për përbarim është bërë në bazë të titullit ekzekutiv-Aktgjykimit C.nr.361/2022 në të cilin aktgjykim është i përfshirë paditësi ndërsa propozimi për përbarim është bërë për paditësin ku ka kërkuar që përfaqësuesit të autorizuar të kreditorit të mos i njihen shpenzimet procedurale.

Kreditori brenda afatit ligjor ka ushtruar përgjigje në prapësim, duke theksuar se prapësimi i debitorit është i pa bazë, me arsyetimin se Urdhëri i Përbarimit privat B.B, është marrë bazuar në dispozitat ligjore, përkatësisht duke u bazuar në dispozitat ligjore të Ligjit Mbi Procedurën Përbarimore, e konkretisht në përputhje me nenin 43 të LPP-së, e duke u bazuar në titullin përbarimor-Aktgjykim. Gjykatës i ka propozuar që prapësimin ta refuzojë si të pa bazuar.

Gjykata pas shqyrtimit të propozimit të kreditorit, urdhrimit për lejimin e përbarimit, prapësimin të debitorit, përgjigjes në prapësim të kreditorit, shkresave të lëndës, ka ardhur në përfundim se prapësimi i debitorit është i pabazuar.

Sipas dispozitave ligjore të Ligjit Nr.04/L-139 (i publikuar në Gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës Nr.3 të dt.31.01.2013, më tej LPP) në nenin 21 përcaktohen bazat juridike për caktimin e përbarimit, "*Organi përbarues e cakton, përkatësisht e zbaton përbarimin vetëm në bazë të dokumentit përbarues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër*", ndërsa me nenin 22 par.1 nënpar.1.1 përcaktohet se "*1.1. Dokumente përbaruese janë: 1.1"vendimi përbarues i Gjykatës dhe ujdia (pajtimi) gjyqësore përbaruese*".

Gjykata vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktvendimi, duke e aprovuar pjesërisht prapësimin e debitorit dhe duke e shfuqizuar P.nr.6585/24, të datës 18.07.2024, sa i përket kërkesës së përfaqësuesit të autorizuar të kreditorit që në emër të shpenzimeve për përpilimin e propozimit për përbarim të paguaj shumën prej 28,08 euro në emër të TVSH-18%, me arsyetimin se këto shpenzime nuk i përkasin dispozitivit të vendimit gjyqësor i cili kërkohet që të përbarohet e as nuk janë të parapara në Tarifën e Odës së Avokatëve.

Gjykata me analizimin dhe shikimin e dokumenti përbarues – Aktgjykimi C.nr.361/2022, i datës 10.06.2024, vërtetoi faktin se debitori ka qenë i obliguar për shkak të detyrimit në të holla në emër të inflacionit, kreditorit, t'ia paguaj shumën e përgjithshme prej 840.00 euro, të gjitha me kamatë ligjore prej 8% në afat prej 15 dite pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Debitori me asnjë prove nuk arriti të vërtetojë faktin se ka kryer pagesën për këtë shumë. Gjykata po ashtu ka vërtetuar faktin se dokumenti përbarimor – Aktgjykimit C.nr.361/2022, i datës 10.06.2024, i dhënë në procedurë gjyqësore është nxjerrë nga organi kompetent, ka marrë formën e prerë me datë 02.07.2024, si dhe i njëjti është i ekzekutueshëm nga data 10.07.2024. Sipas LPP-së nenit 27 par.1 përcaktohet se "*Dokumenti përbarimor është i përshtatshëm për përbarim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit*". Nga kjo rezulton se vendimi në fjalë është titull përbarimor për shkak se e ka të përcaktuar kreditorin dhe debitorin, kohën e përmbushjes së detyrimit, si dhe shumën e përmbushjes, andaj si i tillë është i përshtatshëm për përbarim, andaj edhe vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktvendimi duke e lënë në fuqi urdhrin përbarimor P.nr.6585/24, të datës 18.07.2024.

Gjykata analizoi kundërshtimet e debitorit lidhur me urdhrin për lejimin e përbarimit P.nr.6585/24, të datës 18.07.2024, mirëpo këto pretendime i vlerësoi si të pabazuar, sepse

gjkata në procedurën përbarimore nuk lëshohet në ligjshmërinë materiale të dokumentit përbarues, në bazë të të cilit kërkohet përbarimi. Gjykata në procedurën përbarimore kujdeset se a është bërë propozimi për përbarim dhe a është lejuar përbarimi në bazë të dokumentit përbarues siç kërkohet me dispozitat ligjore në fuqi. Në rastin konkret përbarimi është lejuar në bazë dokumenti përbarimor Aktgjykim, C.nr.361/2022, i datës 10.06.2024, të Gjykatës Themelore në Gjakovë-dega në Rahovec, i plotfuqishëm me datë 02.07.2024, i ekzekutueshëm nga data 10.07.2024, ndërsa kreditorët propozimin për përbarim e kanë parashtruar me datë 18.07.2024, brenda afatit sipas të cilit mund kërkohet përbarimi.

Nga të lartcekurat, duke u mbështetur në dispozitat e nenit 22, 23, 24 par.1 dhe 27 lidhur me nenin 73, 77 par.1 dhe 5 dhe nenit 290 të Ligjit mbi Procedurën Përbarimore, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË -DEGA NË RAHOVEC
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil
PPP.nr.189/2024, dt. 21.10.2024

B.Profesionale
Shpresa Haxhijaha Rahmani

Gj y q t a r i
Avni Berisha

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi pala e pa kënaqur ka të drejtë ankese, brenda afatit prej 7 (shtatë) ditëve, pas ditës së pranimit të tij, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmes kësaj Gjykate Themelore.